Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

PËR VITIN 2019

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi, (udhëheqëse ekipi), Laureta Matoshi dhe Veton Misiri (anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....6

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore....7

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....8

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....23


Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja....28

Shtojca II: Letër Konfirmimi....31

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur dhe menaxhuar mirë, me përjashtim të disa çështjeve të vogla rreth shpalosjeve të pasurisë dhe detyrimeve që i kemi theksuar më poshtë te kategoritë përkatëse.

Ministria në përgjithësi, ka vendosur kontrolle efektive për menaxhimin e të hyrave përderisa për një menaxhim financiar dhe kontroll të mirëfilltë të shpenzimeve, ende nevojiten veprime shtesë. Kjo pasi që devijime janë vërejtur në pothuaj të gjitha fushat e shpenzimeve, përfshirë edhe disa zëra të shpalosjeve.

Zbatimi i rekomandimeve ende mbetet sfidë për MPMS. Edhe pse nga 12 rekomandimet tona të vitit 2018, shtatë ishin zbatuar, një ishte i mbyllur, megjithatë katër nga rekomandimet e pazbatuara janë nga më të rëndësishmet dhe që janë duke u përsëritur nëpër vite. Si rezultat i përsëritjes së rekomandimeve, shumë mangësi në sistemet domethënëse të ministrisë mbesin të pa trajtuara.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm[1]

Opinion i pamodifikuar
Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

[1] Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministri i Financave dhe Transfereve është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, për pjesën që e mbulon kjo ministri sipas rregullores nr. 05/2020[2] dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Përderisa menaxhmenti i MEPTINIS-it për pjesën e trajtuar në këtë raport (çështjen A1) që me rregulloren e lartëcekur mbulohet prej saj nuk ka dhënë ndonjë koment e as nuk ka dërguar letër konfirmimin përkundër ofrimit të afateve shtesë dhe komunikimeve të vazhdueshme. Në këtë rast ne e marrim pajtueshmërinë me raportin si të mirëqenë nga ana e tyre.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit gjatë procesit të auditimit.

[2] Rregullore(QRK) - Nr 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (tash e tutje Ministria) dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Ministria kishte shpenzuar 99% të buxhetit final për vitin 2019 që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive përderisa kontrollet e vendosura në fushën e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm dhe veprime shtesë.

Fusha me probleme më të theksuara është fusha e subvencioneve, kjo për shkak të vonesave në eliminimin e paqartësive rregullative dhe moszbatimit të kërkesave ligjore me rastin e pagesave për personat që përfitojnë më tepër se një pension, po ashtu, në këtë kategori nevojiten kontrolle shtesë tek pagesat e pensioneve pas vdekjes së përfituesve si dhe tek pagesave e pensioneve për personat e punësuar.

Me tutje, Ministria duhet të ndërmarrë veprime për të përmirësuar menaxhimin e proceseve të rekrutimit të stafit, prokurimit, dhe raportimin e plotë të pasurisë dhe obligimeve, çështje këto të ngritura edhe në raportin e vitit paraprak. Sfidë mbetet edhe niveli i ulët i realizimit të projekteve kapitale.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[3]	2019 Realizimi	% Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**466,661,828**	**503,205,273**	**499,323,508**	**99%**	**441,839,080**	**400,156,325**
Granti i Qeverisë –Buxheti	465,961,828	501,937,365	498,235,042	99%	441,479,041	399,879,722
Te hyrat nga AKP[4]	700,000	700,000	699,674	100%	-	-
Donacionet e jashtme	-	567,908	388,792	68%	360,039	276,603

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 36,543,445€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 567,908€, dhe vendimeve të Qeverisë në vlerë 35,975,537€, të cilat kishin të bëjnë kryesisht me ndarjen e mjeteve për mbulimin e obligimeve në skemat pensionale dhe sociale.

Në vitin 2019, Ministria ka shpenzuar 99% të buxhetit final, ngjashëm me vitin paraprak.

[3] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[4] Të hyrat nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të ndara me ligj të buxhetit

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kat. ekonomike:	**466,661,828**	**503,205,273**	**499,323,508**	**99%**	**441,839,080**	**400,156,325**
Pagat dhe Mëditjet	5,319,419	5,159,505	5,158,822	100%	5,085,867	4,872,972
Mallrat dhe Shërbimet	1,844,251	2,061,592	1,946,664	94%	1,780,499	1,926,237
Shërbimet komunale	377,085	392,085	315,803	81%	289,864	316,560
Subvencionet dhe Transferet	453,236,073	491,600,550	489,340,111	100%	433,997,243	392,236,724
Investimet Kapitale	5,885,000	3,991,541	2,562,108	64%	685,607	803,832

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

MPMS, me vendime të Qeverisë kishte përshtatje të buxhetit në pothuajse të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve. Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si dhe investimeve kapitale kishte shkurtime buxhetore, përderisa tek kategoritë tjera kishte rritje.

Rritja më e lartë ishte në kategorin e subvencioneve dhe transfereve ku buxheti final ishte rritur për 38,364,477€ në raport me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte e ndikuar nga vendimi i Qeverisë nr.03/90 të dt.19.02.2019 për rritjen e skemave pensionale. Sipas këtij vendim rritje kishte tek pensionet bazike-sociale prej 20%, pensionet familjare 20%, pensionet invalidor të punës 20%, pensionet e parakohshme "Trepça" 20% si dhe pensionet kontributë-dhënese rritje prej 15%.

Po ashtu, në rritjen e buxhetit final të kësaj kategori kishte ndikuar edhe pagesa e pensioneve të arsimtarëve të viteve të '90 bazuar në Ligjin nr.06/L-073. Këto pagesa janë përfshirë në skemen e pensioneve bazë kontribut-dhënëse të cilat ishin paraparë të fillojnë nga muaji prill 2019, mirëpo në mungesë të buxhetit këto pagesa ishin realizuar në dhjetor 2019 në mënyrë retroaktive.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Ministria në vitin 2019 ishin në vlerë 523,690€. Ato kanë të bëjnë me gjobat nga Autoriteti i Inspektoratit të Punës (AIP) dhe taksat nga Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	**523,960**	**608,429**	**329,374**

Krahasuar me vitin e kaluar, kishte një zvogëlim të të hyrave prej 14%. Këto të hyra transferohen në buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 5,159,505€ i cili ishte realizuar 100%. Numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 808 kurse sipas buxhetit final ishte 875. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar tetë punëtorë të rinj. Kemi testuar shtatë mostra për teste substanciale në vlerë 3,411€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja B1 – Dobësi në konkursin publik dhe procesin e rekrutimit

Gjetja

Sipas nenit 5 - paragrafit 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, kërkohet që në konkurs të përcaktohet kohëzgjatje e emërimit nëse pozita është me afat të caktuar ose të përhershëm.

Në konkursin e rekrutimit të dt.04.04.2019 për katër pozita[5] në 'Shtëpinë e Personave të Moshuar' në Prishtinë nuk ishte cekur kohëzgjatja e emërimit dhe përshkrimi nëse pozita është me afat të caktuar ose të përhershëm.

Ne shqyrtuam procesin e rekrutimit për pozitën "Infermier" ku vërejtëm se, ishte përzgjedhur kandidatja e cila nuk plotësonte njërin nga tri kriteret e vendosura me konkurs, që kishte të bënte me trajnimet në lëmin e infermierisë. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e një pozite të tillë, trajnimet ishin kriter i domosdoshëm për t'u konsideruar.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyra e personelit nuk kishte marrë parasysh rregullat përkatëse me rastin e përcaktimit të përmbajtjes së konkursit si dhe nga mos përfillja e kritereve të vendosura nga komisioni i vlerësimit.

Ndikimi

Mosrespektimi i kritereve të konkursit ndikon në përzgjedhjen e kandidatëve jo meritor dhe pamundëson arritjen e objektivave përkatëse të institucionit. Po ashtu, mangësitë në përmbajtje me rastin e shpalljes së konkursit dëmtojnë transparencën e procesit të konkursit.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit dhe publikimit të konkurseve respektohen kriteret dhe legjislacioni përkatës.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2019 ishte 2,453,677€, prej tyre ishin shpenzuar 2,262,467€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, pajisje të IT-së, derivate, shërbime kontraktuese, shërbime komunale etj. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 85,444€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

[5] Infermier, Ndihmës mjekësor, Servus ushqimi dhe Vozitës

Çështja A1 – Përfitues nga sektorët të cilët nuk ishin paraparë në kontratë

Gjetja

Në kontratën ''Sigurimi ndaj aksidenteve në punë për praktikantë të cilët do të angazhohen për praktikë në Punë në Kompanitë Private'' e nënshkruar ndërmjet Ministrisë dhe kompanisë së sigurimeve, ishin përcaktuar kategoritë dhe profesionet që duhet të jenë përfituese të sigurimeve shëndetësore.

Te pagesa me vlerë prej 36,900€, për sigurimin e 1,350 praktikantëve të angazhuar në kompanitë private dhe publike, kemi identifikuar se 100 prej tyre nuk i përkasin profesioneve që ishin klasifikuar sipas kategorive të përcaktuara me kontratë. Projekti për punësimin e praktikantëve ishte marrëveshje ndërmjet ministrisë dhe GIZ-it si bashkëfinancues i këtyre aktiviteteve.

Ndikimi

Sipas zyrtarëve të Ministrisë fakti se marrëveshja ishte me GIZ dhe nuk përmbante kufizime si dhe në mungesë të aplikantëve të profesioneve të kontraktuara, ministria kishte vendosur që t'ju ipet mundësia e përfitimit edhe aplikantëve të profesioneve tjera. Futja në listën e përfituesve të profesioneve - kategorive që nuk janë paraparë me kontratë rrezikon mundësinë e kompensimit të sigurimeve shëndetësore në rast të ndonjë fatkeqësie dhe e gjithë kjo rezulton me mosarritje të objektivave të projektit. Për fat të mirë nevojat për përfitimin e sigurimeve shëndetësore si rezultat i lëndimeve në punë nuk kishin ndodhur.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të siguroj përmes menaxherëve përkatës, që lista e profesioneve të paguar për përfitime shëndetësore të jetë në përputhje me kontratën. Po ashtu, në inicimin e kërkesës duhet bërë një analizë e mirëfilltë e profesioneve - punëkërkuesve që do të mbështeten, në mënyrë që mos të ketë devijime nga kushtet e vendosura me kontratë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 491,600,550€, i cili ishte shpenzuar 489,340,111€, apo pothuajse 100%. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve përbëjnë 98% të shpenzimeve të përgjithshme të Ministrisë. Këto kanë të bëjnë kryesisht me skemat pensionale dhe sociale.

Falë bashkëpunimit me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe me Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK), ministria në vazhdimësi po bënë përpjekje për t'i reduktuar pagesat e parregullta të cilat ishin identifikuar nga auditimet e viteve paraprake tek disa nga skemat pensionale dhe sociale. Megjithatë, mbetet sfidë edhe më tej menaxhimi i këtyre skemave, me theks të veçantë tek përfituesit e dyfishtë si dhe pagesat e pensioneve për personat e punësuar.

Kemi zhvilluar procedura analitike substanciale krahasuese për skemat pensionale dhe sociale, ndërsa për pjesën tjetër të subvencioneve dhe transfereve që nuk është e aplikueshme kjo metodë, kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 7,069,981€. Ndërkaq, për teste të pajtueshmërisë kemi testuar 113 mostra.

Ndryshe nga viti i kaluar, ku gabimi ishte 1,166,982€, këtë vit vlera e gabimit për skemat e njëjta është 1,258,829€, me një rritje të lehtë prej 91,847€.

Çështja B2 – Kontrolle jo efektive në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja

Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së dhe ARC-së, kemi konstatuar si në vijim:

- **Përfitimi i pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale** - Vlera e këtyre pagesave për vitin 2019 ishte 124,632€. Kjo kishte ndodhur për shkak të deklarimeve të mëvonshme që bëhen në ATK dhe që reflektohen në muajt përkatës, për të cilat nuk kishte informata në kohën kur ishin bërë krahasimet mujore nga ana e ministrisë; dhe

Tabela 4. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar (në euro)

Lloji i skemës pensionale	Numri i pagesave	Gabimi Financiar
Pensionet Trepça	335	28,091
DFDIL- Veteran	643	52,331
Ndihma Sociale	408	44,210
Gjithsej	**1,386**	**124,632**

- **Pagesa e pensioneve pas vdekjes së përfituesve** - Vlera e të cilave ishte 142,345€. Kjo kishte ndodhur për arsye se regjistrimi i vdekjeve në ARC ishte bërë me vonesë dhe për këto raste Ministria nuk ishte në dijeni.

Tabela 5. Pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve

Lloji i pensionit (skemës pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2019		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2019		Totali i pagesave pas vdekjes së përfituesve	
	Nr. i pagesave	Shuma (€)	Nr. i pagesave	Shuma (€)	Nr. i pagesave	Shuma (€)
Kompensim për persona të verbër (KV)	13	3,250	69	17,625	**82**	**20,875**
Pensionet Bazë (PB)	139	11,925	380	35,880	**519**	**47,805**
Pensionet Kontributive (PK)	63	11,952	135	26,979	**198**	**38,931**
Pensionet për personat me aftësi të Kufizuara (PPAK)	39	3,975	40	3,075	**79**	**7,050**
Pensionet Trepça	3	315	3	378	**6**	**693**
DFDIL Familjar	8	1,706	23	6,516	**31**	**8,222**
DFDIL Veteran	21	3,570	14	2,329	**35**	**5,899**
Pensionet e TMK-së	0	0	0	0	**0**	**0**
Pensionet për paraplegjikët dhe tetraplegjikët (PPTP)	39	7,500	17	4,575	**56**	**12,075**
Pensionet Familjare	9	795	0	0	**9**	**795**
Gjithsej	**334**	**44,988**	**681**	**97,357**	**1,015**	**142,345**

Ndikimi Mbajta e personave të vdekur në listat e përfituesve të pensioneve si dhe përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar dëmtojnë buxhetin e ministisë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.

Çështja B3 - Pagesat pa bazë të qartë ligjore

Gjetja Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe ndihmat sociale, kemi konstatuar se Ministria kishte kryer pagesa në vlerë prej 991,852€ pa bazë të qartë ligjore. Rastet më të shpeshta të përfitimit të më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, janë përfituesit që i takojnë kategorisë së TMK-së dhe FSK-së, të cilët përfitojnë edhe pensione tjera.

Tabela 6. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

Lloji i skemës pensionale	Numri i pagesave	Gabimi Financiar në Euro (€)
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe DFDIL_Familjar	944	227,454
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe DFDIL_Veteran	86	20,302
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe DFDIL_Familjar	3395	738,288
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe DFDIL_Veteran	13	1,598
Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL_Familjar	17	1,500
Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL_Veteran	7	630
Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL_Familjar	0	0
Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL_Veteran	5	850
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara (PPAK) dhe DFDIL_Familjar	2	150
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara (PPAK) dhe DFDIL_Veteran	0	0
DFDIL – Familjar dhe PIP	12	1,080
Trepça - DFDIL-Veteran	0	0
KV –DFDIL- Familjar	0	0
Gjithsej	**4481**	**991,852**

Për çështjen më lartë, Ministria kishte kryer pagesa të tilla edhe në vitet paraprake deri në muajin shtator 2018 kur edhe ishin ndërprerë ato, për tu kthyer përsëri me vendim të Qeverisë NR.12/82 të dt. 28.12.2018.

Me këtë vendim ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK-në dhe TMK-në deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale nga institucioni i ngarkuar me këtë kompetencë.

Kjo praktikë e këtyre pagesave ka vazhduar edhe në vitin 2019, pasi që deri në përfundimin e auditimit për vitin 2019, ministria nuk kishte arritur të siguroj interpretim të bazës ligjore për skemat pensionale në fjalë apo të përditësojë kornizën ligjore aktuale, siç edhe parashihet me Strategjinë Sektoriale 2018-2022 të aprovuar nga Qeveria.

Ndikimi Pagesa e pensioneve për personat të cilët janë përfitues të më shumë se një skemë pensionale mund të shkaktojnë dëmtim të përfituesve të pensioneve apo dëmtim të buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi B3 Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,991,542€, prej tyre ishin shpenzuar 2,562,108€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive për rastet sociale, renovimin e Qendrave të Aftësimit profesional, ndërtimin e rrugëve lokale etj. Kemi testuar pesë mostra për teste substanciale në vlerë 262,017€, si dhe pesë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja A2 – Realizim i ulët i projekteve kapitale

Gjetja Sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2019, Ministria në tabelat e projekteve kapitale kishte fonde të parapara për të realizuar 21 projekte në vlerë 5,885,000€. Prej 21 projekteve të planifikuara, në shtatë (7) prej tyre nuk kishte pasur asnjë shpenzim gjatë vitit. Si rezultat i përformancës jo të mirë, me vendime të qeverisë buxheti ishte zvogëluar për 1,893,458€. Përkundër zvogëlimit të buxhetit të projekteve, Ministria nuk kishte arritur të realizonte më shumë se 64% të tij.

Në këtë nivel të ulët kishte ndikuar mungesa e kërkesave për inicimin e procedurave për këto projekte, vështirësitë në realizimin e disa projekteve për shkak të kompleksitetit të tyre si dhe bashkëfinancimet me komuna.

Ndikimi Mosrealizimi i disa nga projektet e planifikuara rezulton në shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion dhe e gjithë kjo ndikon në mos arritjen e objektivave të parapara dhe rrjedhimisht edhe në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të shtojë kontrollet e brendshme të cilat do të ndikojnë në rritjen e shkallës së realizimit të buxhetit në këtë kategori. Dhe se, realizimi projekteve kapitale duhet të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore duke i adresuar barrierat për realizim të projekteve me kohë dhe në nivel të planifikuar.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 20,664,235€, pasurive jokapitale është 143,535€, si dhe e stoqeve 25,923€. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 352,846€, si dhe procesin e inventarizimit si test të pajtueshmërisë.

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja B4 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Sipas Rregullores Nr.02/2013 nenit 19 pika 4.7 për Menaxhimin e Pasurive, raporti i inventarizimit duhet të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Respektivisht sipas nenit 3, Pasuri Kapitale – nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare materiale dhe jo materiale që blihen, ndërtohen, krijohen apo përvetësohen në ndonjë mënyrë tjetër dhe që: a) kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit dhe që synohet të përdoren vazhdimisht; b) kanë vlerë financiare 1,000€ apo me shumë; dhe c) pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te organizatat buxhetore.

Lidhur me menaxhimin e pasurive ne kemi vërejtur si në vijim:

- Ministria kishte themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo i njëjti nuk kishte arritur ta përfundoj këtë proces para përgatitjes dhe dorëzimit të PFV-ve. Deri në kohën sa ishim në auditim (mars 2020), i njëjti nuk kishte arritur të përfundoj punën dhe të na siguroj një raport për punën e tij;

- Regjistri i pasurisë nën 1,000€ kishte probleme me rastin e bartjes së shënimeve (të konfirmuara nga Ministria) të cilat ishin reflektuar nga azhurnimi i këtij regjistri nga MAP dhe ne nuk kemi mundur të marrim siguri se i njëjti është i saktë, përkundër se me mostrat e testuara nuk ka rezultuar ndonjë çështje; dhe

- Nga mostrat e testuara nga regjistri i pasurisë mbi 1,000€, kemi identifikuar një softuer me vlerë origjinale 27,500€ dhe vlerë të mbetur prej 3,928€ që figuronte si pasuri. Kjo vlerë kishte të bënte vetëm me gjysmën e pagesës së softwerit, i cili nuk ishte finalizuar dhe vënë në funksion asnjëherë nga ministria. Shpenzimet në lidhje me këtë softuer ishin të buxhetuara në kodin e kapitaleve (projekt për zhvillimin e softuerit për APRK[6]-në). Mirëpo, realisht puna e pranuar për këtë pjesë të softuerit kishte të bënte me shpenzime të periudhës të cilat nuk do të duhej të kapitalizoheshin.

Dobësitë e identifikuara ishin reflektuar nga kontrollet e brendshme joadekuate në lidhje me menaxhimin e pasurisë.

[6] Agjencia për Punësimin në Republikën e Kosovës

Ndikimi Mbajtja në regjistra e pasurive që nuk janë funksionalizuar asnjëherë dhe nuk përdoren nga ministria ndikon në mbivlerësimin e pasurisë. Në anën tjetër, mungesa e inventarizimit pamundëson harmonizimin e gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, dhe rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet apo tjetërsohet duke reflektuar edhe në paraqitjen jo të drejte të vlerës së pasurisë në PFV.

Rekomandimi B4 Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje, duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.

2.3 Të arkëtueshmet

Ministria në PFV-të e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 490,400€. Ato kanë të bëjnë me gjobat e shqiptuara nga inspektorati i punës. Krahasuar me vitin e kaluar llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 207,772€ (2018 - 282,628€), kjo rritje ishte si rezultat i mosinkasimit të një numri të gjobave të shqiptuara nga inspektorati i punës.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 2,035,444€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Shumica e këtyre detyrimeve janë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, përkatësisht obligime për provizione bankare dhe obligime për përfituesit e disa skemave pensionale të cilat kanë mbetur pa u paguar në muajin dhjetor për shkak të mungesës së buxhetit.

Çështja A3 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimit

Gjetja

Neni 39 i LMFPP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Nga shqyrtimi i pagesave përmes vendimeve gjyqësore të Ministrisë, kemi identifikuar se si rezultat i mos pagesës së obligimeve me kohë për OE dhe përfituesit e pensioneve, të njëjtit përmes procedurave gjyqësore i kishin realizuar të drejtat e tyre ligjore. Vlera e ekzekutuar nga Thesari të vendimeve gjyqësore ishte 57,995€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 48,304€ dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbarimit) ishin 9,691€. Arsyet e mos pagesës me kohë të obligimeve ishin pranimi me vonesë i faturave, kontestimi i të drejtës së përfituesit nga ana e ministrisë dhe në disa raste mungesa e buxhetit.

Pagesat kryesisht kishin të bënin me pensionet që përfituesit i kishin fituar me rastin e padisë, për të cilat ministria e konteston të drejtën e tyre dhe pagesat e vonuara për operatorët ekonomik si rezultat i pranimit me vonesë të faturave në financa për shkak të mungesës së koordinimit brenda ministrisë.

Ndikimi

Pagesat përmes vendimeve gjyqësore ndikojnë në rritjen e pa arsyeshme të shpenzimeve të ministrisë, pasi ministria nuk do të marrë në këmbim asnjë mall/shërbim për pjesën e shpenzimeve që tejkalon borxhin kryesor.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurojë marrjen e masave për kryerjen e pagesave me kohë dhe kontrolle të shtuara në menaxhimin e duhur të obligimeve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë të paarsyeshme.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja B5 - Shpalosje e pasaktë e detyrimeve kontingjente në PFV

Gjetja	Neni 18 i PFV-ve kërkon shpalosjen e vlerës së plotë dhe të saktë të detyrimeve kontingjente të organizatave buxhetore. Ministria në PFV-të e saj kishte shpalosur detyrime kontingjente në vlerë 3,658€, ndërsa vlera që do të duhej të shpalosej ishte 8,767€. Regjistri ishte mbivlerësuar për një faturë në vlerë 1,974€, që ishte prezantuar edhe pse e njëjta ishte paguar gjatë vitit 2019, që kishte të bënte me furnizime që ishin vonuar për t'u paguar nga ana e Ministrisë. Ndërsa, ishte nënvlerësuar për një faturë në vlerë 7,083€, e cila nuk ishte prezantuar edhe pse ishte pranuar gjatë vitit 2019, që kishte të bënte me mos pagese të obligimeve për një pezullim të një punëtori në kohën që ishte në procedurë gjyqësore, e që kishte rezultuar i pafajshëm me ç'rast ministria i detyrohej për kthim të pagesave të ndalura. Kjo ka ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur me rastin e përgatitjes së PFV-ve.
Ndikimi	Shpalosjet jo të plota dhe të sakta të detyrimeve kontingjente ndikojnë në prezantim jo të drejtë të tyre në PFV.
Rekomandimi B5	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2020 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjen e saktë të detyrimeve kontingjente.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Ndërkaq, vlera e detyrimeve kontraktuale të MPMS në fund të vitit 2019 ishte 2,039,664€. Këto janë kontrata në vazhdim, që kanë qenë të buxhetuara dhe të lidhura me afat më të gjatë se një vit në vlerë totale prej 3,330,458€. Gjatë vitit 2019 për to ishte paguar shuma 1,290,794€, ndërkaq pjesa tjetër janë punë që do të kryhen dhe paguhen në vitin 2020.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

MPMS ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me katër auditorë dhe udhëhiqet nga Drejtori i NJAB-së. Për vitin 2019, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik, ku kishte planifikuar 34 auditime të rregullta dhe një sipas kërkesës. NJAB gjatë vitit 2019 kishte arritur të realizojë në tërësi planin vjetor të auditimit.

Në kuadër të auditimeve të kryera ishin përfshirë shumica e njësive organizative të MPMS, me prioritet sistemet me rrezik më të lartë, siç janë: njësitë e skemave pensionale, financat dhe

prokurimi. Periudha e mbuluar kryesisht në raportet e NJAB përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Numri i rekomandimeve të dhëna nga NJAB për vitin 2019 ishte 140 rekomandime.

Në kuadër të MPMS është i themeluar dhe funksionon edhe Komiteti i Auditimit, i cili për vitin 2019 kishte mbajtur katër takime.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të MPMS ka rezultuar në 12 rekomandime. MPMS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Ministria ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, shtatë rekomandime janë zbatuar dhe katër rekomandime nuk janë adresuar, përderisa një rekomandim është i mbyllur i pazbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 7 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 7. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Po ashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.	Edhe pse gabimet janë të ngjashme dhe kanë rezultuar edhe këtë vit me diferenca nga krahasimi i këtyre data bazave, ne ketë mangësi nuk e kemi vendosur te theksimi i çështjes por te kategoria e Subvencioneve. Shih rekomandimin B3.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar.
2		Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministritë tjera.	Ministria për vitin 2019 kishte ndërprerë pagesat e tilla pas këtij rekomandimi dhe i kishte kthyer përsëri pas sigurimit të dëshmive për ardhje vajtje nga punonjësit përkatës.	Rekomandim i zbatuar.
3		Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjen e saktë të pasurive dhe detyrimeve kontingjente. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Shpalosje jo të sakta për pasuritë dhe detyrimet kontingjente kanë rezultuar edhe në PFV-te e vitit 2019. Shih rekomandimin B4 dhe B5.	Rekomandim i pa zbatuar

4		Ministri duhet të siguroj se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode adekuate siç parashihet me planin kontabël të SIMFK-së me qëllim të prezantimit dhe shpalosjes së drejtë të informatave për shfrytëzuesit e PFV-ve.	Nga testimet tona në vitin 2019 nuk kemi hasur në gabime të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
5	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit, kriteret përcaktohen sipas legjislacionit përkatës duke respektuar në tërësi procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.	Nga shqyrtimi i konkurseve për vitin 2019 kemi hasur në mosrespektimit të kritereve me rastin e rekrutimit të stafit dhe mangësi tjera në procedurat e rekrutimit (publikim të konkursit). Shih rekomandimin B2.	Rekomandim i pa zbatuar.
6		Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës.	Në vitin 2019 kontratat ishin lidhur me procedura dhe nuk kemi hasur në marrëveshje që kane tejkaluar kohëzgjatjen e përcaktuar me ligj.	Rekomandim i zbatuar.
7	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të sigurojë se nuk do të ketë asnjë kompensim shtesë për stafin e angazhuar brenda orarit të rregullt të punës.	Nga shqyrtimi i mostrave nga ky kod për vitin 2019 dhe konfirmimit nga ZKF janë ndaluar pagesa të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
8	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për	Rekomandim i pa zbatuar.

		përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.	zbatimin e këtij rekomandimi. Shih rekomandimin B3.	
9	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që pranimi i të gjitha pajisjeve të bëhet konform kontratës me qëllim që të arrihen objektivat e njësisë kërkuese.	Nga testimet tona në vitin 2019 nuk kemi hasur në gabime të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
10	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë kontrollet në menaxhimin, regjistrimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.	Gabime të njëjta të pasurisë kane rezultuar edhe nga testimet tona të vitit 2019. Shih rekomandimin B4.	Rekomandim i pa zbatuar.
11	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve. Po ashtu duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuara protokollohen.	Nga testimet tona në vitin 2019 nuk kemi hasur në gabime të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
12	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë hartimin e regjistrit të rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.	Ministria gjatë vitit 2019 ka përpiluar listën e rreziqeve.	Rekomandim i zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit dhe publikimit të konkurseve respektohen kriteret dhe legjislacioni përkatës.		

2	Mallrat dhe shërbimet	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherëve përkatës, që lista e profesioneve të paguar për përfitime shëndetësore të jetë në përputhje me kontratën. Po ashtu, në inicimin e kërkesës duhet bërë një analizë e mirëfilltë e profesioneve - punëkërkuesve që do të mbështeten, në mënyrë që mos të ketë devijime nga kushtet e vendosura me kontratë.
3	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.
4		Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.
5	Investimet kapitale	Ministri duhet të shtojë kontrollet e brendshme të cilat do të ndikojnë në rritjen e shkallës së realizimit të buxhetit në këtë kategori. Dhe se realizimi projekteve kapitale të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore duke i adresuar barrierat për realizim të projekteve me kohë dhe në nivel të planifikuar.
6	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje, duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.
7	Detyrimet	Ministri duhet të sigurojë marrjen e masave për kryerjen e pagesave me kohë dhe kontrolle të shtuara në menaxhimin e duhur të obligimeve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë të paarsyeshme.
8		Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2020 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjen e saktë të detyrimeve kontingjente.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 01
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 479
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 9
Data / Datum / Date: 12.05.2020
Dalëse
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije i Transfere – Ministry of Finance and Transfers

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, për pjesën që tashmë mbulon Ministria e Financave dhe Transfereve sipas Rregullores Nr. 05/2020 ; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Me respekt!
Besnik Bislimi
Ministër i Financave dhe Transfereve

Prishtinë
12.05.2020